



QENDRESA
QYTETARE

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

ARSIMI I LARTË, SFIDA PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT



8 DHJETORI
I STUDENTËVE,
JO POLITIKËS

Qëndresa Qytetare, me mbështetjen e Fondacionit gjerman Friedrich Ebert, kërkon të nxisë debatin publik mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, me qëllim miratimin e politikave të ndërlidhura me realitetin dhe që synojnë përmirësime pozitive të realitetit, sidomos në një fushë me ndikim të thellë në jetën në vend, siç është ajo e arsimit dhe kërkimit shkencor.

RAPORT

Arsimi I lartë, Sfida per plotesimin dhe ndryshimin e ligjit

BOTUES



**QËNDRESA
QYTETARE**

Punuan:

Msc. Rigels Xhemollari
Msc. Rudina Niklekaj

Ndihmuan:

Migen Qiraxhi
Dragan Kurti
Valmira Kosova

Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare me mbështetjen financiare të Fondacionit Friedrich Ebert. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Tiranë 2021

PËRMBAJTJE

1. Konteksti dhe problematikat e reformimit të arsimit të lartë në vend
2. Metodologjia
3. Peshë e votës studentore
4. Kredia Studentore dhe Sigurimi i Studentëve
5. Kriteri i notës mesatare për degët e mësuesisë
6. Rregulloret e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës
7. Programet e dedikuara të Transparencës në universitetet publike
8. Rekomandime



1. KONTEKSTI DHE PROBLEMATIKAT E REFORMIMIT TË ARSIMIT TË LARTË NË VEND

Arsimi i lartë dhe reforma arsimore universitare ka qenë dhe mbetet një nga temat më të rëndësishme publike në vend. Reforma e Arsimit të Lartë është adresuar në një sërë tryezash dhe debatesh publike përgjatë viteve, të cilave iu shtuan dhe protestat studentore të muajit Dhjetor 2018. Prej vitit 1990 ligjet e miratuara kanë synuar reformimin e sistemit universitar, por përvoja tregon se ky reformim mund të ketë zgjidhur problemet afatshkurtra por nuk ka pasur vision për një legjislacion të qëndrueshëm. Megjithëse prej vitit 1990 arsimi i lartë ka pasur 3 reforma të thella, kuadri ligjor nuk e ka nxitur në masën e duhur reformimin e brendshëm të jetës universitare duke përfshirë kurrikulat, kërkimin shkencor dhe rolin e studentit brenda jetës universitare.

6 vjet pas miratimit të reformës në arsimin e lartë, universitetet publike dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, që janë dy institucionet kryesore të ngarkuara për zbatimin e kësaj reforme kanë shfaqur mangësi dhe problematika në përmbushjen e detyrave që u paracakton ligji.

Nga njëra anë Minsitria e Arsimit ka bllokuar procesin e doktoraturave prej 8 vjetësh duke i pamundësuar qindra të rinjve ndjekjen e ciklit të tretë të studimeve vetëm për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore për zbatim të ligjit 80/2015.

MAS mban të centralizuar aksesin e maturantëve në universitete dhe lirinë e kurrikulave akademikë duke ju

LIGJ
Nr. 80/2015
PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Misioni i arsimit të lartë

lënë vetëm 40% liri akademike në ndryshimin e tyre. Nga ana tjetër universitetet publike nuk e kanë përthithur sa duhet lirinë që u ka ngarkuar ligji, dhe nuk kanë mundur t'i përshtaten tregut të punës. Gjithashtu, nuk kanë pasur vullnet të kalojnë në filtrin e cilësisë dhe integritetit profesorët e tyre, pavarësisht se u është vënë në dispozicion një program anti - plagjiaturë.

Qëndresa Qytetare në këtë vlerësim të dytë të zbatimit dhe përthithjes së ligjit 80/2015 synon të orientojë aktorët kryesorë të arsimit të lartë drejt zgjidhjeve ligjore për disa nga çështjet që prekin studentët dhe jetën akademike.

Ekipi i Qëndresës Qytetare ka përgatitur një sërë propozimesh dhe amendimesh ligjore që kanë në fokus përmirësimin e ligjit, reformimit të arsimit të lartë dhe vetë universiteteve publike, me qëllim zbatimin e plotë të ligjit dhe prioritarizimin e studentëve si faktor kyç i jetës universitare.

Zgjedhjet në universitete, të zhvilluara në vitin 2020, ishin një tregues i qartë se fryma brenda auditorëve duhet të ndryshojë. Kjo pasi mendimi dhe liria e të shprehurit është e cunguar për sa kohë drejtuesit zgjidhen vetëm nga vartësit e tyre ndaj të cilëve mund të hakmerren nëse nuk votohen. Rritja e peshës së votës studentore do të çtensiononte përplasjet mes klaneve të akademikëve dhe do të hapte mundësinë e demokratizimit të jetës universitare duke e orientuar drejt projekteve konkrete. Madje kjo do të ulte edhe nivelin e ndikimit të partive politike në jetën universitare. Por ligjvënësit dhe vetë organet drejtuese akademike nuk kanë shprehur optimizëm në këtë aspekt.

Kredia Studentore është një mjet efikas për të përmirësuar cilësisht jetën e studentit duke lehtësuar barrën financiare të familjeve shqiptare. Mungesa e akteve nënligjore për kredinë studentore sipas nenit 114 të ligjit për arsimin e lartë e ka bërë të pazbatueshëm këtë aspekt të ligjit. Në të njëjtën kohë, universitetet publike shpenzojnë qindra mijra euro për sigurinë e godinave, pajisjeve dhe sistemit të kamerave, por kanë "harruar" të zbatojnë detyrimin ligjor për sigurimin e studentëve.

Kriteri i notës mesatare për degët e mësuesisë ka cuar drejt mbylljes dhjetra programe studimi të cilat prej vitesh diplomojnë kimistë, biologë, historianë, arkeologe, sociologe por për shkak të aksesit që këto programe kanë në mësuesi pranimi i studentëve është vështirësuar. Modifikimi i VKM për rritjen e notës mesatare në programet me akses mësuesinë dhe stimulimi me bursa i mësuesve të rinj do të jetë një nga propozimet tona në këtë raport.

Kjo paketë propozimesh do të përfshijë edhe dy mekanizma ligjorë që përmirësojnë sistemin e ankesave dhe transparencën e fakulteteve dhe universiteteve të cilat aktualisht parashikohen në ligj por nuk janë funksionale. Rregulloret e Fakulteteve bazuar në ligjin 80/2015 dhe programet e dedikuara të transparencës janë dy nga sugjerimet e Qëndresës Qytetare në drejtim të strukturave drejtuese së universiteteve publike.

Kryeministri Edi Rama në datën 10 shtator 2021, gjatë një takimi me anëtarët e rinj të Bordit të Akreditimit pranoi për herë të parë se ligji i arsimit të lartë mund ti nënshtrohet ndryshimeve duke iu drejtuar atyre “Ne do ju shfrytëzojmë sa të mundemi. S’ka ligj perfekt ka nevojë për axhustime. Na vlen shumë ekspertiza juaj”.¹

Pra edhe vetë kreu i qeverisë, pas një periudhe të gjatë konsistence për të mos e prekur ligjin pranon që ky ligj ka nevojë për amendime. Ky është një moment shumë i mirë politik për të ndërhyrë në legjislacionin e arsimit të lartë dhe për të realizuar ndryshime në favor të studentëve dhe cilësisë së arsimit e cila vitet e fundit lë për të dëshiruar.

2. METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË RAPORTIT

Metodologjia e përgatitjes së këtij materiali është bazuar në mendimet dhe opinionet e ekspertëve të arsimit të lartë, pedagogëve dhe studentëve të angazhuar dhe në studimin e shembujve të universiteteve të Rajonit dhe vendeve të Bashkimit Evropian që aplikojnë sistemin e Bolonjës. Duke qënë se është një raport shoqërues i propozimeve konkrete për ndryshime në ligj apo akte nënligjore është përdorur teknika legjislative që përdoret edhe për aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga fakti që shpesh herë në vendin tonë reformat dhe ndryshimet ligjore kalojnë nëpër shumë burokraci është menduar që materiali t’i prezantohet Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, Qeverisë dhe IAL-ve duke ushtruar presion të vazhdueshëm nga studentët dhe media për të arritur në miratimin e ndryshimeve të propozuara.

¹ <https://tvklan.al/ligji-per-arsimin-e-larte-do-te-ndryshoje/>



3. PESHA E VOTËS STUDENTORE

Vota e studentëve është një instrument demokratik që rrit demokracinë e drejtpërdrejtë të studentëve në përzgjedhjen e organeve drejtuese akademike dhe vendimmarrjes në organet kolegjiale si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Në ligjin për arsimin e lartë të miratuar në vitin 2007 pesha e votës studentore ishte në masën 20%. Pas miratimit të ligjit 80/2015 në vitin 2015 pesha e votës së studentëve për zgjedhjen e organeve drejtuese në universitete u reduktua në masën 10%. Gjatë protestës studentore të vitit 2018 një ndër 8 pikat që studentët i drejtuan qeverisë ishte edhe rritja e peshës së votës studentore në masën 50%. Në adresimet që qeveria i bëri kërkesave të studentëve në dhjetor 2018 refuzoi kërkesën për rritjen e peshës së votës në 50% i argumentuar si një peshë vote e paprecedentë në Rajon apo Evropë.

Aktualisht pesha e votës së studentëve në IAL-të publike është 10% dhe referuar zgjedhjeve të vitit 2016 dhe 2020, votat e studentëve nuk ishin përcaktuese për zgjedhjen e asnjë dekani apo rektori. Kjo situatë solli mungesën e platformave, debatit dhe alternativave drejtuar studentëve për qeverisjen e universiteve.

Diferenca aktuale në vendimmarrjen për zgjedhjen e përfaqësuesve akademikë është në dispropocion gjithashtu me peshën numerike që zënë subjektet që përbëjnë universitetin, ku studentët janë rreth 90% e popullatës si edhe përfituesit kryesorë të shërbimeve dhe vendimmarrjes ndërsa pedagogët përfaqësojnë rreth 10% të popullatës dhe paguhen

nga tarifat e studentëve për të kryer shërbimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda universitetit. Per ilustrim në Universitetin e Tiranës vota e 1 pedagogu vlen sa vota e 314 studentëve dhe në Universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit vota e 1 pedagogu vlen sa 456 studentë. Kjo diferencë nuk përmbush dhe as nuk shkon drejt parimit të barazisë së votës.

Ndërsa lidhur me mungesën e precedentit, i cili ka qënë edhe një ndër arsyet e forta që qeveria nuk e ka pranuar rritjen e peshës së votës, atë së pari e gjejmë në nenin 21, pika 4 të ligjit nr. 9741, dt.21.05.2017 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", votat e studentëve në zgjedhjen e organeve akademike vlenin në masën 20% të totalit dhe votat e administratës në masën 5% të totalit.

Ndërsa si shembull të huaj mund të përmendim rastin e zgjedhjeve për rektor në Universitetin e Barcelonës, ku studentët zotërojnë 30% të peshës së votës dhe vota e tyre ka qënë përcaktuese në zgjedhjet e vitit 2016 ku rektor u zgjodh Prof. Joan Elias.² Gjithashtu në vendet që aplikojnë sistemin e Bolonjës, Rumania është shteti që aplikon peshën e votës së studentëve në zgjedhjet akademike në masën 25%.



Rritja e peshës së votës studentore shmang përfshirjen e grupimeve partiake dhe kërkon të organizuar në zgjedhjet për universitete. Rritja e peshës së votës dhe përfaqësimit të studentëve në strukturat e universiteteve publike rrit transparencën, llogaridhënien dhe i bën universitetet më demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Prandaj, mbështetja e kësaj nisme ligjore është jo vetëm një premtim i realizuar i kërkesës së drejtë të studentëve në protestat e Dhjetorit 2018, por edhe një shërbim i çmuar që i bëhet përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë dhe demokratizimit të universiteteve. Kjo nismë e shëndrron studentin nga spektator në aktor vendimmarrës.

² <http://www.ub.edu/eleccionsrektorat2016>

PROPOZIMI KONKRET PREK TRE NENE TË LIGJIT AKTUAL PËR ARSIMIN E LARTË TË CILAT TRANSFORMOHEN SI MË POSHTË:

Neni 37, pika 4 të ndryshohet si vijon:

Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën tridhjetë për qind, ndërsa në institucionet jopublike përfaqësohen në masën e përcaktuar në statutin e institucionit.

Neni 39 pika 2 të ndryshohet si vijon:

Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën tridhjetë për qind (30%) të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetë-kandidohen.

Neni 42 pika 3 të ndryshohet si vijon:

Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën tridhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kriteret specifike përzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcaktohen në statutin e IAL-së përkatëse.

Aktualisht Qëndresa Qytetare ka depozituar në parlament projektligjin për ndryshim dhe relacionin shoqërues por Komisioni Parlamentar i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik ende nuk e ka marrë në shqyrtim këtë projekt – akt.³



4. KREDIA STUDENTORE DHE SIGURIMI I STUDENTËVE

Në shumicën e vendeve të Bashkimit Europian dhe më gjerë, studentët me pamjaftueshmëri të ardhurash mbështeten me kredi të buta për të vijuar studimet e tyre. Kredia kryesisht mbulon shpenzimet e shkollimit, akomodimit, ushqimit dhe blerjes së librave apo mjeteve të tjera shkollore. Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në

Republikën e Shqipërisë e parashikon Kredinë Studentore në nenin 114 të tij. Sipas këtij neni Ministria përgjegjëse për arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve, me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostos së studimeve. Kredia studentore është e hapur për aplikim për të gjithë studentët që fitojnë të drejtën për studime në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë. Skema e kreditimit studentor përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 114 Kredia studentore

1. Ministria përgjegjëse për arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve, me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostos së studimeve.

2. Kredia studentore është e hapur për aplikim për të gjithë studentët që fitojnë të drejtën për studime në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë.

3. Skema e kreditimit studentor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Anglia, si shteti ku gjenden disa prej universiteteve më të mirë dhe më të vjetër në botë, është njohur për tarifat e larta studentore dhe jetesën e shtrenjtë. Megjithatë kjo do të ndikonte negativisht në numrin e studentëve në fakt sipas statistikave për 2019-2020 (Staista, 2020) numri i studentëve ka shkuar në 2.53 milionë studentë. Kjo vjen si rrjedhojë e sistemit financiar për studentët Anglezë, i cili u vendos në vitin 2012. Ky sistem ofron paketa lehtësuese dhe kredi studentore që jo vetëm

shërbejnë si magnet për të tërhequr studentët drejt universiteteve por edhe janë një indikator mbi rëndësinë e rolit që arsimi i lartë dhe studentët kanë. Studentët që marrin kredi studentore për të ndjekur studimet e larta nuk vuajnë nga barra financiare e interesave që vijnë në shlyerjen e kësaj kredie. Përkundrazi, shlyerja e këtij borxhi nis në momentin që studenti regjistrohet si një individ i cili përfiton një pagesë (apo është i vetë-punësuar) prej 25, 750 Paund në vit. Nga ky moment nga paga e tij tërhiqen automatikisht për 30 vite rjesht 9% e cdo shume që fitohen mbi këtë page. Cdo pjesë e mbetur e kredisë pas 30 vitesh konsiderohet automatikisht e shlyer.

Nga ana tjetër, Gjermania ka që në vitin 1971 që ka implementuar kreditë për studentët gjermanë i cili njihet si “BAföG”. Ky program ka si qëllim krijimin e mundësive të barabarta mes të rinjve gjermanë në mënyrë që të gjithë të kenë qasje në arsimin e lartë. Deri më tani më shumë se 4 milion të rinj kanë perfituar nga kredia studentore. Shlyerja e kesaj kredie është pa përqindje interesi dhe konsiston në një shumë prej maksimalisht 10,000 Euro.

Nisur nga niveli i lartë i tarifave në vend, në raport me vendet e Rajonit, niveli i lartë i jetesës dhe mungesa e njësive akomoduese pranë njësive universitare e bën të nevojshëm këtë instrument lehtësues për jetën studentore të të rinjve shqiptarë. Për të mundësuar këtë instrument efikas duhet që Këshilli i Ministrave menjëherë të përcaktojë skemën e kreditimit studentor e cila duhet të përmbajë:

- Kriteret dhe procedurat e përfituesve të Kredisë Studentore
- Mënyrën, kohëzgjatjen dhe afatet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë
- Normat e interesit dhe kohëzgjatjen e shlyerjes së kredisë pas përfundimit të studimeve dhe punësimit të studentit.
- Mënyrën e subvencionimit paraparak dhe mbulimit të intereseave nga shteti deri në fillimin e shlyerjes nga vetë student të kredisë.

Qeveria shqiptare më datë 22 etor 2021 miratoi Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj ku megjithëse në objektivin specifik C.5 thuhet “Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të asistencës financiare”, përsëri kredia studentore mungon si element në fokusin e strategjisë së qeverisë shqiptare.

Neni 98, pika dh i Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë parashikon si të drejtë të garantuara nga ligji, sigurimin e studentit nga institucioni i arsimit të lartë, në një ndër

shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrisë përgjegjëse. 6 vite pas hyrjes në fuqi të ligjit ende nuk kemi një akt nënligjor (Udhëzim të Minisitrit) në zbatim të këtij neni për të detyruar institucionet e arsimit të lartë që të sigurojnë studentët gjatë periudhës së studimit. IAL-të si njësi autonome mund të shfaqin risqe të ndryshme për shkak të fatkeqësive natyrore, falimentit apo gabimeve njerëzore për të cilat studentët duhet të jetë të siguar nëse veprimtaria e marrjes së shërbimit universitar ndërpritet. Një rast i ngjashëm u shfaq edhe gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, ku disa universitete arritën të përshtaten ndaj mësimi online, por nëse kjo nuk do të ndodhte atëherë studentët nuk do të kishin mundësi kompesimi të dëmit të shkaktuar ndaj tyre për periudhën e ndërprerjes së veprimtarisë mësimore.

Prandaj, në zbatim të plotë të ligjit 80/2015 kërkohet që Minsitri i Arsimit të nxjerrë Urdhrin në zbatim të nenit 98, pika 'dh' ku shprehimisht të thuhet se:

“Ngarkohen institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike në vend, të nënshkruajnë kontrata me një ndër shoqëritë e sigurimit në vend, me qëllim mundësimin e siguracionit të çdo studenti për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera.”

Në një kohë ku IAL-të publike shpenzojnë qindar mijra euro për sigurimin e godinave dhe pajisjeve, duhet që një pjesë të buxhetit, i cili buron nga tarfiat e studentëve të shkojë për sigurimin e vetë veprimtarisë mësimore, e cila është jetike dhe e domosdoshme për vetë studentët.

5. KRITERI I NOTËS MESATARE PËR DEGËT E MËSUESISË

Me ndryshimin e ligjit për arsimin e lartë në vitin 2015, ndryshoi edhe mënyra e aksesit të studentëve në universitete, ku një peshë të madhe mori Ministria e Arsimit dhe Rrjeti Akademik Shqiptar që përlogarit pikët e cdo maturanti dhe e rankon sipas sistemit meritë-preferencë tek programi i studimit të përzgjedhur nga vetë studenti. Kjo praktikë e largoi më tej studentin nga universiteti dhe kriteret e fakulteteve duke i dhënë peshë kryesore maturës shtetërore si proces hyrës në universitet e jo dalës nga shkolla e mesme. Ndryshimet e shpeshta të kriterëve të pranimit gjatë rrugës së formimit të tyre nuk i ndihmojnë maturantët që të përputhin ritmet e studimeve të tyre me këto kriterë.

Nga ana tjetër, në aspektin strategjik, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk adreson në mënyrë të decentralizuar procesin e pranimeve në IAL-të publike, si për ciklin e ciklin e parë të studimeve, ashtu edhe për të dytin, edhe pse Ligji 80/2015, në nene të ndryshme të tij i ka njohur një sërë kompetencash universiteteve për mbarëvajtjen e procesit pranues të studentëve.

Nota mesatare dysHEME e përcaktuar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave përbën risk që target grupi i studentëve me mesatare më të ulët të synojë studimin jashtë Shqipërisë duke qenë se ky kriter nuk aplikohet në të gjitha vendet. Gjithashtu, i aplikuar pa një strategji dhe në mënyrë të menjëhershme, kriteri i mesatares mund të ndikojë në raportin mësimdhënie-mësimnxënie apo dhe sjelljen ndaj një vlerësimi real të dijes në arsimin parauniversitar.

Ato që e vuajnë më shumë këtë politikë janë degët me akses në ciklin master në mësim. Për vitin akademik 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019 mesatarja ishte 6, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 kjo

mesatare u rrit në 6.5 (gjashtë pikë pesë). Për vitin akademik 2020-2021 për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë është minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë) dhe për vitin akademik 2021 – 2022 e vijim është miratuar të aplikohet në notën 8, ndërkohë që kjo mesatare për programet në tërësi është për vitin akademik 2020-2021 6.5 (gjashtë pikë pesë) dhe vitin akademik 2021 – 2022 e vijim është miratuar të jetë në notën 7.5 (shtatë pikë pesë).

Duhet theksuar se programet e studimit të ciklit bachelor në degët e mësuesisë janë programe që nuk diplomojnë mësues, pasi ky titull fitohet pas përfundimit të ciklit të dytë master. Kjo politikë shtetërore nuk ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësuesve, madje politika, sipas së cilës një gamë e gjerë e degëve të studimit të ciklit të parë cilësohen si degë që japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, me justifikimin që ky është një profesion i rregulluar, po penalizon universitetet duke rrezikuar mbylljen e shumë degëve.

Nga analiza e kryer prej Qëndresës Qytetare gjatë vitit akademik 2019 –

Fakulteti	Dega	nr. stud.
1.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Angliere	17
2.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Program Profesional 2-shejor*	12
3.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Teknologji e Informacionit	61
4.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Teknologji Laboratoriale 2-shejor*	46
5.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Program Profesional 2-shejor*	60
6.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Mësues për Arsimin Parashor	16
7.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Psikologji Sociale	35
8.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Edukator për Niveli D & 3-shejor	57
9.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Edukator i Fëmijëve dhe Shkollës	40
10.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Administrativ - Bionet	40
11.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Financë - Kontabilitet	57
12.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Historia dhe e Shpirtit	24
13.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Informatikë Ekonomike	23
14.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Historia Tullme	13
15.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Administrativ Bionet dhe Shkollës	12
16.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Drejtësi	69
17.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Informacion e Proje/Inovacion	300
18.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Informacion - Manti	130
19.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Informacioni	76
20.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Ligjor	12
21.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Shkollës	70
22.FAKULTETI SHKENCËS MËKËSORE TE	Teknik Laboratoriale	72
23.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Italiane	9
24.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Angliere	9
25.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë dhe Gjuhë Italiane	7
26.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë dhe Gjuhë Italiane	0
27.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Historia dhe Gjuhë Germane	0
28.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë dhe Gjuhë Romë	0
29.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Italiane	0
30.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Italiane	0
31.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë Italiane	0
32.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Biologji - Kimi	3
33.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Matematikë - Fizikë	1
34.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Fizikë - Sociologji	0
35.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Psikologji	7
36.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Mësues për Arsimin Parashor	8
37.FAKULTETI SHKENCËS TE EDUKIMIT	Edukator 2-shejor	0
38.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Edukator 2-shejor	0
39.FAKULTETI SHKENCËS TE NATËS	Matematikë - Informatikë	0
40.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	6
41.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Historia - Gjeografia	6
42.FAKULTETI SHKENCËS HUMANË	Gjuhë shqipe dhe Italo	0
TOTALI I STUDENTEVE		1196

UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI", ELBASAN

20/42 DEGE
Drejt mbylljes

I vetmi univ. me
ulje te nr te
studenteve me
-17 nga 2019 (rreth 2)
+ 101 Student (R3)
+ 1 Dege Shpëton

2020 në lidhje me degët dhe lëndët mësimore në universitetet publike, degët si "Historia", "Gjeografia" dhe "Gjuha shqipe" ishin drejt mbylljes në të gjitha universitetet e rretheve. 4 Ne universitetin e

Elbasanit dhe të Gjirokastrës, pothuajse gjysma e degëve të studimit po shkojnë drejt mbylljes, specifikisht 12 nga 21 degë janë drejt mbylljes në Gjirokastrë dhe 20 nga 42 drejt mbylljes në Elbasan.

⁴ <https://citizens-channel.com/2020/11/05/raporti-rriten-regjistrimet-ne-deget-qe-te-cojne-jashte-vendit-59-drejte-studimi-ne-rrezik-mbyllje/>

Nisur nga pabarazia e notës mesatare, bazuar në cilësinë e ofrimit të mësimit në arsimin parauniversitar, dëmtimin që ky kriter i ka sjellë degëve të universiteteve të cilat japin akses edhe për mësuesi por jo vetëm propozojmë që **VKM nr.436, dt 03/06/2020** të ndryshojë si më poshtë:

Pika 2/b Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2021 – 2022 dhe në vijim, përkatësisht si më poshtë:

Në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr.2 të këtij vendimi, minimalisht me **notën 7 (Shtatë)**.⁵

Ekspertët e arsimit janë të njëzëri se kriteri i notës mesatare duhet të vinte si pasojë e një studimi të të dhënave të mëparshme mbi pranimet në universitete. Kryesisht, ky kriter gjykohet si më i nevojshëm të aplikohet për kalimin nga cikli i parë i studimeve (diploma 'Bachelor') në ciklin e dytë të studimeve (programet Master) për të siguruar një hyrje të lirë dhe dalje sipas meritës nga universiteti.



6. RREGULLORET E FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Universiteti i Tiranës funksionon bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe statutin e miratuar në vitin 2018. Implementimi i ligjit të miratuar në vitin 2015 krijoi paqartësi në aspektin e organizimit të IAL-ve për shkak të vonesës së nxjerrjes së akteve nënligjore dhe mungesës së interpretimit të tyre të drejtë nga organet drejtuese në universitete. Kjo paqartësi vinte edhe për shkak se organet e IAL-ve nuk arritën të hartojnë dhe miratojnë statutet dhe rregulloret e tyre të brendshme për të detajuar kompetencat. Universiteti i Tiranës miratoi statutin 3 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit, ndërsa debate mbi rregulloren e universitetit vijon të jetë në fokus sot, 5 vjet pas miratimit të ligjit në fushatën zgjedhore për rektorë dhe dekanë.⁶

Sipas nenit 33 të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre përbërëse rregullojnë veprimtarinë e tyre në rregulloret e tyre të brendshme, që hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Në statut, në përputhje me këtë ligj dhe me vendimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, përcaktohen hollësisht: organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe të

⁶ <https://www.ascal.al/media/documents/qaa%20eer/University%20of%20Tirana%20EER%20AL.pdf>


studentëve, si dhe çështje të tjera që regullojnë veprimtarinë e institucionit.⁷

Ndërsa sipas nenit 12 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Fakulteti e mbështet veprimtarinë e tij në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në aktet nënligjore në fuqi, në këtë Statut, në rregulloren e UT-së, si dhe në rregulloren e fakultetit.⁸ Pavarësisht parashikimeve ligjore, Universiteti i Tiranës dhe njësitë kryesore të tij (Fakultetet) nuk kanë hartuar Rregullore të brendshme për të detajuar dhe rregulluar marrëdhëniet që lindin si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015, duke lënë ende në fuqi rregulloret e vjetra të cilat praktikisht janë bërë nul për shkak të të drejtave dhe detyrimeve të reja që lindin për organet drejtuese pas ndryshimeve ligjore të vitit 2015.


Fakulteti i Shkencave Sociale për organizimin e punës së brendshme i referohet Rregullores së miratuar me Vendim nr. 24, datë 18.11.2010 të Këshillit të Fakultetit.⁹ Edhe fakultetet e tjera e kanë zgjidhur në mënyrë të ngjashme. Rregullorja e fakultetit, përveç se strukturon punën e organeve sipas ligjit, i jep mundësi ligjore studentëve të shprehën, të ankohen dhe të kërkojnë shërbime cilësore. Bazuar në një anketim të realizuar nga studentët e shkencave sociale 48.6% e studentëve të pyetur nuk kanë depozituar një ankesë për shkak të mungesës së

A keni adresuar/depozituar ndonjëherë ndonjë ankesë mbi çështjet e mëposhtme?

Konflikt me pedagogen/un



Cilësinë e mësimdhënies



⁷ <https://openuniversity.al/wp-content/uploads/2018/10/Ligji-80-2015-P%C3%ABr-Arsimin-e-Lart%C3%AB-dhe-k%C3%ABrkimin-shkencor-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf>

⁸ https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf

⁹ https://docs.google.com/file/d/0B0Dzyl_ABclyZ0FzU29kX3J4MUE/edit?pli=1

informacion mbi mekanizmat e ankimit ndërsa 13.2% e tyre janë shprehur se kanë arsye të tjera të cilat i kanë penguar të ankohen.

Të pyetur në lidhje me procedurat ankimore në fakultet dhe rastet konkrete, 26.2% e studentëve të pyetur janë përgjigjur se janë ankuar pas një konflikt me pedagogen/un e tyre, ndërsa 71.8% e studentëve shprehen se nuk kanë adresuar ndonjë ankesë të kësaj natyre. Sa i përket cilësisë së mësimdhënies numri i studentëve që kanë depozituar ankesë është më i ulët (16.7%) ndërsa 83.3% e tyre nuk janë ankuar më parë për mësimdhënien. Këto shifra tregojnë se më së shumti studentët përdorin mekanizmat e ankimit në rastet kur krijohet një konflikt në raportin pedagog – student sesa në qasjen metodologjike apo programe që kanë lektorët gjatë zhvillimit të orëve të mësimi, laboreve apo projekteve të tyre shkencore.



7. PROGRAMET E DEDIKUARA TË TRANSPARENCËS NË UNIVERSITETET PUBLIKE

Në vitin 2014 u miratua ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit i cili përbënte një risi për mentalitetin e instaluar deri në atë kohë nga institucionet publike dhe aksesin e shumtë që ju ofron qytetarëve dhe organizatave. Ligji shqiptar për të drejtën e informimit sipas KDIMP është konsideruar si një ndër pesë ligjet më të mira në botë. Ky ligj kishte për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe për herë të parë parashikonte masa administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara në të.

Autoritetet publike, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të venë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, si edhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Komisioneri për të Drejtën e Informimit fillimisht përgatiti një program model të përgjithshëm për të gjitha institucionet, por ligji parashikonte në nenin 6 të tij se Komisioneri duhet të përgatisë programe model të transparencës për kategori të veçanta të institucioneve, përfshi edhe universitetet publike.

Qëndresa Qytetare prej vitit 2018 monitoron financat e universiteteve ku çdo vit evidentohen problematika dhe mangësi sa i përket transparencës, transaksioneve dhe përdorimit të parave të tarifave të studentëve. Edhe pse qeveria urdhëroi krijimin e portalit u-transparenca, për të publikuar të gjitha cv e pedagogëve apo të dhënat financiare të universiteteve, ky portal aktualisht është jo funksional.

Fusha 1. Mbi organizimin dhe funksionimin e Universiteteve Publike në Republikën e Shqipërisë						
Nr	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike të këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikim
1	Universiteti bën publike: Përbërja e universitetit në njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera: - Fakultete - Departamente - Qendra kërkimore shkencore - Qendrat studimore ndërdisiplinore - Strukturat shëndetësore universitare - Degë studimi	Neni 7, i ligjit nr. 119/2014 Nenet 22 – 29 të ligjit 80/2015	a.Në faqen zyrtare të internetit menu (me link) b.Vendet e caktuara për njoftimet publike (caktohet adresa)	Menjëherë	Senati akademik	Rektori
2	Organe kolegjiale drejtuese akademike (Përbërja, struktura dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të: Senati Akademik - Anëtarët - Funksionet Asambleja e Personelit akademik - Përbërja - Funksionet Komisionet e përhershme - Përbërja dhe funksionet e komisioneve: - Për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor"	Neni 7, i ligjit nr. 119/2014 Nenet 36 – 56 të ligjit 80/2015	a.Në faqen zyrtare të internetit menu (me link) b.Vendet e caktuara për njoftimet publike (caktohet adresa)	Menjëherë Vendimet e Senatit akademik – brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre. Njoftimi për mbledhjen e senatit akademik 5 ditë para datës së zhvillimit.	Senati Akademik Këshilli i Etikës	Rektori

Qëndresa Qytetare në bashkëpunim me Friedrich Ebert ka punuar për përgatitjen e një Programi Model të Transparencës të dedikuar për universitetet publike. Drafti tashmë i shqyrtuar edhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është gati për t'u miratuar.

Një program i tillë për institucionet e arsimit të lartë është thelbësor për të rritur transparencën por edhe për të ndarë përgjegjësitë akademike nga ato administrative mes Rektorit dhe Adminsitatorit të institucionit.


Programi i dedikuar i Transparencës, ndryshe nga ai normal duhet të përmbajë:

- Përbërja e universitetit në njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera
- Organe kolegjiale drejtuese akademike (Përbërëria, struktura dhe kompetencat).
- Aktet ligjore që rregullojnë jetën akademike dhe universitare
- Autoritetet drejtuese akademike, përfshi kompetencat dhe deklaratat e pasurisë së tyre
- Bordet e administrimit
- Administritoritn e universitetit dhe ata të njësive kryesore
- CV, gradat dhe titujt shkencorë të personelit akademik
- Buxheti vjetor së bashku me dokumentat shoqërues të tij
- Raportet e zbatimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor
- Programet e Studimit që ofron universiteti.
- Shërbimet administrative.
- Kontratat publike.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të procedojë me miratimin e Programit të Dedikuar për Universitetet dhe drejtuesit e Universiteteve duhet ta zbatojnë vendimin e KDIMP duke integruar në faqet e tyre zyrtare programin e ri bazuar në ligjin për të drejtën e informimit publik. Në këtë mënyrë do të jemi një hap pranë transparencës së plotë të shumë treguesve që momentalisht lënë për të dëshiruar nga ana e IAL-ve publike.

REKOMANDIME

- Parlamenti shqiptar duhet të miratojë ndryshimin e neneve 37, 39 dhe 42 të ligjit 80/2015 me qëllim rritjen e peshës së votës dhe përfaqësimit të studentëve nga 10% në 30%.
- Këshilli i Ministrave duhet të miratojë VKM-në për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor, në zbatim të nenit 114 të ligjit për Arsimin e Lartë.
- Këshilli i Ministrave duhet të ndryshojë VKM nr.436, dt 03/06/2020, pika 2/b për të mundësuar pranimin në programet e ciklit të parë “Bachelor”, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë minimalisht me notën 7 (Shtatë).
- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të nxjerrë Urdhrin në zbatim të nenit 98, pika ‘dh’ të ligjit 80/2015 për mundësimin e të drejtës së studentëve për të siguruar veprimtarinë mësimore të tyre nga ana e universiteteve publike.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të miratojë Programin e Dedikuar të Transparencës për institucionet e arsimit të lartë.
- Fakultetet e Universitetit të Tiranës duhet të miratojnë Rregulloret e njësive bazë, bazuar në nenin 33 të ligjit 80/2015, statutin dhe rregulloren e këtij universiteti.



QENDRESA
QYTETARE

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG